



Prishtinë, 27.02.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3091_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2774_10_25** i datës 17.10.2025;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 17.12.2025.

në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **Y.H., (S. H.)**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2774_10_25 i datës 17.10.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 17.10.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2774_10_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit Y. H., lidhur me kontestimin e faturimit me matje për sezonën ngrohëse 2024/25, si dhe kontestimin e komponentës së tarifave të konsumit të përbashkët.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori Y. H., brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Fillimisht konsumatori pohon të mos jenë respektuar afatet ligjore në shqyrtimin e ankesës së tij;
- Saktësia e njehsorëve të energjisë termike nuk është inspektuar asnjëherë, dhe se pajisjet matëse nuk janë testuar ose kalibruar;
- Konsumatori e konteston edhe komponentën e konsumit të përbashkët, me arsyetimin se, paguan më shumë, edhe me radiatorët e fukur;
- Kërkon zbritjen e faturave të fryra, të largohen matësit nga banesa jonë, të hiqet konsumi i përbashkët dhe të kthehet faturimi me sipërfaqe ngrohëse.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit të dt. 17.12.2025; Vendimin e DMK-së të dt. 17.10.2025, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 07.05.2025, Përgjigjen e NQ Termokos e dt. 24.03.2025, Faturat e kontestuara, Kartelën e konsumatorit me shifër 006139; të dhënat nga leximi dhe faturimi për gjithë sezonën ngrohëse 2024/25; Informacionet e NQ Termokos të dt. 01.09.2025, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit është e pabazuar, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, vihet re që, konsumatori për sezonën ngrohëse 2024/25, për muajt 10-11 është faturuar me sipërfaqe ngrohëse, ndërkaq, duke filluar nga muaji 12/2024 i ka pranuar faturat e energjisë termike me matje ose C11. Ndërlidhur me faturimin me matje dhe pa matje për disa konsumatorë, përgjatë muajve të sezonës ngrohëse 2024/25, nga NQ Termokos kanë sqaruar se: *“Procesi i faturimit ka vazhduar në mënyrë graduale, për shkak të kalimit nga faturimi manual në faturim me matje (lexim). Edhe pse disa konsumatorë kanë pasur pajisje matëse të instaluar, gjatë muajve tetor dhe nëntor 2024 faturimi është bërë nga Termokos, pasi procesi i leximit nuk ishte përfshirë ende në të gjitha objektet. Ky kalim është bërë me faza, ku një pjesë e konsumatorëve janë faturuar nga Termokos, ndërsa pjesa tjetër nga Enerco, derisa u plotësua procesi i integritetit të leximeve. Pas përfundimit të kësaj faze, pra pas tre muajve, të gjithë konsumatorët që kanë pajisje matëse janë përfshirë në faturim në bazë të leximit (C11 ose C33 ma matës). Aktualisht, vetëm objektet që ende nuk kanë pajisje matëse vazhdojnë të faturohen nga Termokos – Divizioni i Faturimit”*.

Bordi thekson se, i ka analizuar me kujdes faturat e kontestuara për sezonin ngrohës 2024/25 dhe thekson se, të njëjtat janë të sakta dhe se nuk është evidentuar ndonjë parregullsi në faturim, përfshirë këtu edhe komponentin e konsumit të përbashkët. Po ashtu, janë analizuar me kujdes edhe të dhënat e dërguara nga NQ Termokos lidhur me numrin e impulseve të regjistruara për çdo muaj të sezonës ngrohëse, dhe është konstatuar se, si të tilla janë të sakta dhe pasqyrojnë me saktësi energjinë termike të shpenzuar nga konsumatori.

Ndërlidhur me kontestimin e konsumit të përbashkët, si komponent e tarifave - konsumi i përbashkët i energjisë termike, paraqet sasinë e energjisë termike të pamatur nga matësit individualë të nxehtësisë, por përfshihet në faturë. Shpërndarja e konsumit të përbashkët, llogaritet dhe faturohet bazuar në pjesëmarrjen e sipërfaqes ngrohëse të njësisë së banimit, gjegjësisht të lokalit afarist, ndaj totalit të sipërfaqes së ndërtesës kolektive. Konsumi i përbashkët, përbën 20% të konsumit të energjisë termike në ndërtesë kolektive. Konsumi i përbashkët u faturohet të gjitha njësive banesore – me matës dhe pa matës – dhe vlera ndryshon çdo muaj, varësisht nga konsumi total i energjisë termike.

Më tej, Bordi i ka analizuar edhe të dhënat lidhur me nënstacionin 171 - QE, nga i cili furnizohen me energji termike të gjithë banorët e objektit në fjalë dhe ka gjetur se, konsumi i përbashkët si komponentë e tarifave të energjisë termike, u është shpërndarë të gjithë konsumatorëve në mënyrë proporcionale dhe në harmoni me metodologjinë e përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.



Ndërlidhur me kërkesën e konsumatorit për kthim të faturimit me sipërfaqe ngrohëse, duke iu referuar nenit 30 – Pajisjet matëse, të Ligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike, është e përcaktuar si në vijim: ***“Furnizimi me energji termike matet me pajisje matëse ndërsa, instalimi, operimi, mirëmbajtja apo zëvendësimi i pajisjeve për matje, bëhet në pajtim me Kodin e Matjes. Energjia termike e shfrytëzuar nga konsumatori llogaritet me pajisje për matje që është pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Tek konsumatorët fundor individual - objekte individuale të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në pikën e furnizimit, sa më afër kufirit të pronës së konsumatorit”, aty ku është e mundur, çdo herë duhet t’i jepet përparësi faturimit me matje, në krahasim me faturimin me sipërfaqe ngrohëse, për shkak që, mundëson kursim, eficiencë dhe kontrollim të shpenzimit nga vet konsumatori, andaj edhe kërkesa e konsumatorit për kthim të faturimit me sipërfaqe ngrohëse, përkundër që i ka matësit e instaluar dhe funksional, është e pabazuar.***

Faturimi me sipërfaqe ngrohëse, për konsumatorët të cilët i kanë të vendosur matësit/alokatorët, do të zbatohet vetëm përkohësisht dhe në mungesë të leximit të saktë të shpenzimit të energjisë termike nga konsumatori, si bie fjala, kur sistemi matës mund të ketë ndonjë defekt teknik dhe kjo, vetëm përkohësisht, deri në sanimin e problemit. Sipas të dhënave të pranuar nga NQ Termokos, të gjithë konsumatorët të cilët kanë pasur të instaluar pajisje matëse HCA (alokator) apo edhe pajisje matëse, janë faturuar pa matje/me sipërfaqe ngrohëse, për shkak të defekteve që këto pajisje i kanë shfaqur në sistem. Rrjedhimisht, në mungesë të të dhënave të sakta për impulset e regjistruara, e që do të rezultonin në faturim të pasaktë, për këta konsumatorë, është aplikuar forma e faturimit me SN dhe se praktikisht, nuk ekziston një mënyrë tjetër e faturimit.

Në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike me nr. 01/2022, gjegjësisht neni 16 – Struktura Tarifore dhe Faturimi, si në vijim: ***“Për konsumatorët me matje (siç është përcaktuar në paragrafin 5 të Nenit 15) tarifat duhet të jenë si në vijim: a) Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa (pagesa) mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes [€/kW për muaj]; b) Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo € cent/kWh]; c) Nëse më shumë se një konsumator është i kyçur në një nënstacion (‘ndërtesat me shumë njësi’), atëherë konsumi i matur në këtë nënstacion do të shërbej si matje bazë për faturim, ndërsa alokimi tek konsumatorët bëhet si në vijim: c.1) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në shtojcën ‘8’; dhe 16 c.2) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ nuk ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi i konsumit të matur në nivel nënstacioni duhet të alokohet tek secili konsumator i kyçur proporcionalisht me sipërfaqen ngrohëse [m²], është i përcaktuar komponenti i konsumit të përbashkët, dhe rrjedhimisht, pretendimi i konsumatorit që kjo komponentë nuk përfshihet në tarifa, është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar.***

Më tej, edhe duke iu referuar Shtojcës 8 – të Metodologjisë së Alokimit të Kostos së ngrohjes në ndërtesat me shumë njësi kolektive, tek Parimet Kryesore është përcaktuar si vijon: ***“Fatura e ngrohjes e konsumatorëve që banojnë në ndërtesat kolektive do të përbëhet nga: i) komponentët fiks: që merr parasysh kapacitetin termik të konsumatorit dhe konsumin e përbashkët të energjisë termike (ngrohjes) të ndërtesës, dhe do t’u tarifohen konsumatorëve pavarësisht nga sasia e ngrohjes së konsumuar; dhe ii) komponenti variabël që do të llogaritet në bazë të sasisë së matur të ngrohjes së konsumuar.***



Tutje, pika d) e Bilancit të Konsumit të Energjisë Termike (ngrohjes) së një ndërtese me shumë njësi (kolektive), parashihet si në vijim: *“Në ndërtesën me shumë njësi, krahas konsumit të ngrohjes së njësisë, është prezent edhe ‘konsumimi i përbashkët’, në formën e: i) transmetimit të nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër hapësirat e përbashkëta të ndërtesave (korridoret, shkallët etj.); ii) transmetimi i nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër njësi (në rastin e përdorimit të HCA-ve të montuar në radiatorë); dhe iii) transmetimin e nxehtësisë ndërmjet mureve dhe tavaneve të njësisë ngjitur”*.

Duke u bazuar në nenin 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si në vijim: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”*, DMK thekson se, NQ Termokos, ka vepruar në harmoni me kërkesat ligjore që burojnë nga legjislacioni sekondar.

DMK thekson se, duke u bazuar në nenin 6 – Furnizimi me Energji termike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë termike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë termike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast. Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrike, listat e leximit, Procedurën e Leximit dhe Faturimit të konsumatorëve tariforë, si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **Y.H., (S. H.,)**
- Arkivit të ZRrE-së